

01-400/01-0036586/21
 Nr. i fq./Br. st. 2
 Data/Datumi 18.05.21
 Shprehës Mitrovica



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
 KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN
 02 Nr. / Br. 875/21
 Nr. i fq. / Br. st. -02-
 Data: / Datum 30.07.2021
 VUSHTRRI VUČITRN

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
 Opština Južna Mitrovica
 Municipality of Mitrovica South



Komuna e Vushtrrisë
 Opština Vučitrn
 Municipality of Vushtrri



Komuna Skënderaj
 Opština Skenderaj
 Municipality of Skënderaj

Në përputhje me Nenin 17.1 (k) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe në përputhje me statutet komunale përkatëse, komunat, Mitrovica e Jugut/ Južna Mitrovica, Vushtrri/Vučitrn dhe Skenderaj/Skenderaj (në tekstin e mëtejshëm: Komunat), bien dakord mbi këtë:

Memorandum i Mirëkuptimit (MM)

për të mbuluar shpenzimet operationale të organizatës jo-qeveritare që menaxhon Strehimoren për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në baza Gjimore, "Raba Voca", për vitin 2021.



Neni 1 - Qëllimi i Memorandumit

- 1.1 Ky Memorandum, i nënshkruar nga komunat, do të sigurojë mbështetje financiare për nevojat themelore operative të Strehimorës për mbrojtjen e viktimave të dhunës në baza gjimore, "Raba Voca" (në tekstin e mëtejshëm "Strehimore"), për vitin 2021, me mundësi të përtëritjes, në rast se nuk do të gjendet një zgjidhje afatgjatë.
- 1.2 Shpenzimet operative drejtohen në mënyrë specifike për pagesën e qirasë pronarit privat të ndërtesës në të cilën Strehimorja është vendosur, për shpenzimet e energjisë elektrike dhe për shpenzimet e shërbimeve publike.
- 1.3 Strehimorja gjendet në Komunën e Mitrovicës së Jugut/Južna Mitrovica, dhe u shërben viktimave të dhunës në familje nga të tri komunat, të cilat janë pale nënshkruese të këtij Memorandumi.

Neni 2 - Synimi i Memorandumit

- 2.1 Komunat do të mbulojnë shpenzimet e Strehimores në lidhje me pagesën e qirasë, energjisë elektrike dhe shërbimeve publike.
- 2.2 Komunat duhet të bien në dakord për të ndarë koston totale për Strehimoren e lartpërmendur, në proporcion me numrin e popullsisë që jeton në secilën komunë;

Neni 3 - Obligimet dhe Burimet financiare

3.1 Komunat do të mbulojnë pjesën e vet të shpenzimeve totale për vitin 2021 në raport me numrin e popullsisë së çdo komune, si në vijim:

Komuna e Mitrovicës: 3,392.16 €

Komuna e Vushtrrisë: 3,208.80 €

Komuna e Skenderajit: 2,567.04 €

Neni 4 - Dispozitat përfundimtare

4.1 Strehimorja raporton mbi shpenzimet e mbuluara nga Komunat në baza mujore, deri në skadimin e këtij Memorandumi;

4.2 MM do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit. Kryetarët e komunave përkatëse duhet të sigurojnë zbatimin e plotë të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

Mitrovicë, 17.05.2021

Nënshkruesit

Agim Bahtiri, Kryetar

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Xhafer Tahiri, Kryetar

Komuna e Vushtrrisë

Bekim Jashari, Kryetar

Komuna e Skenderajit